VENDIM
Nr. 43, datë 17.10.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtar e “	“	
Altina Xhoxhaj	anëtar e “	“	
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datën 16.7.2013, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen me nr. 23 Akti, që i përket:

KËRKUES: Klaudio Ligori

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Shoqëria e Përmbarimit “Strati Bailiff’s Service” sh.p.k.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5945, datë 16.7.2010, i plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 1, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 27, 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të kërkuesit, prapësimet e subjektit të interesuar, Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi Klaudio Ligori për periudhën prej vitit 1999 deri në datën 1.2.2010 ka kryer detyrën e specialistit në Drejtorinë e Hetimit, Departamenti Operativ dhe Hetimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, me vendimin nr. 352/7 prot., datë 26.1.2010, ka marrë masën disiplinore ulje një shkallë në kategori, nga C1 në C2, dhe transferimin nga pozicioni i punës, për një periudhë 1-vjeçare, në degën e Doganës, Vlorë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5945, datë 16.7.2010, i plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010, ka vendosur: Pranimin e kërkesëpadisë së kërkuesit për anulimin e vendimit nr. 352/7 prot, datë 26.1.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave; rikthimin e paditësit në vendin e mëparshëm të punës; detyrimin e palës së paditur/subjekti i interesuar t’i paguajë paditësit/kërkuesit diferencën e pagës nga data 27.1.2010 deri në datën 4.5.2010 si specialist në Drejtorinë e Hetimit, kategoria C1; detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit pagën prej datës 4.5.2010 deri në momentin e kthimit në vendin e mëparshëm të punës si specialist në Drejtorinë e Hetimit, kategoria C1.

4. Mbi ankimin e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1624, datë 8.7.2011, plotësuar me vendimin nr. 466, datë 25.10.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 5945, datë 16.7.2010, plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 2399, datë 15.11.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit të subjektit të interesuar.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3523, datë 8.3.2012, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. 5945, datë 16.7.2010, i plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1624, datë 8.7.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

7. Kërkuesi, në datën 27.7.2012, i është drejtuar me shkresë shoqërisë përmbarimore "Strati Bailiff's Service" sh.p.k. për të filluar procedurat e ekzekutimit.

8. Shoqëria përmbarimore "Strati Bailiff's Service" sh.p.k., me shkresën nr. 5271 prot., datë 27.7.2012, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për ekzekutimin vullnetar të detyrimit. Njoftimi ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ka vijuar me shkresat nr. 5431 prot., datë 2.8.2012 dhe nr. 2050 prot., datë 22.2.2013.

9. Gjatë periudhës së zhvillimit të procesit gjyqësor për anulimin e urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave për masën disiplinore të uljes në detyrë, me shkresën nr. 5844 prot., datë 4.5.2010, kërkuesi ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga puna në degën e doganës Vlorë.

10. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, me vendimin nr. 5839/5 prot., datë 17.5.2010, ka vendosur largimin nga puna të kërkuesit nga dega e doganës Vlorë.

11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2335, datë 12.3.2012, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, si dhe anulimin e vendimit nr. 5839/5 prot., datë 17.5.2010, për largimin nga puna.

12. Mbi ankimin e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2122, datë 18.9.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2335, datë 12.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

13. Mbi rekursin e subjektit të interesuar kundër vendimit nr. 2122, datë 18.9.2012 të Gjykatës së Apelit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) me vendimin nr. 317, datë 15.2.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit.

14. Në të njëjtën periudhë, subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me shkresën nr. 12262/3 prot., datë 16.8.2012, i është drejtuar Gjykatës së Lartë duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 5945, datë 16.7.2010, i plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010, lënë në fuqi me vendimin nr. 1624, datë 8.7.2011 të Gjykatës së Apelit, i plotësuar me vendimin nr. 466, datë 25.10.2011. Për këtë vendim Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) ka vendosur mospranimin e rekursit. Pas kësaj kanë filluar procedurat e ekzekutimit.

II

15. ***Kërkuesi***, në datën 30.4.2013, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, pika 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si rrjedhojë e mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5945, datë 16.7.2010, i plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

16. ***Subjekti i interesuar***, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur duke argumentuar:

16.1. Në çështjen në shqyrtim nuk ndodhemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për më tepër kërkesa rezulton të jetë pa objekt. Kërkuesi pretendon ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të cilat kanë vendosur në lidhje me anulimin e aktit të transferimit dhe uljes në kategori. Ndërkohë kërkuesi është larguar nga puna, duke iu ndërprerë marrëdhëniet e punës. Në këto kushte, vendimi i gjykatës, për rikthimin në pozicionin e mëparshëm, nuk duhet të zbatohet.

16.2. Vendimi objekt kërkese do të ishte i mundshëm për t'u ekzekutuar nëse kërkuesi do të ishte në marrëdhënie pune. Pasojat e një akti administrativ janë në varësi të asaj që ka përcaktuar akti. Pavlefshmëria e një akti i çon palët në gjendjen e mëparshme. Pavlefshmëria e transferimit e çon kërkuesin në pozicionin e mëparshëm dhe pavlefshmëria e largimit nga puna e çon atë në vendin e punës në degën e Doganës Vlorë.

16.3. Pozicioni i punës ku pretendon kërkuesi të kthehet, nuk ekziston më në organikën aktuale të Drejtorisë së Hetimit.

17. ***Subjekti i interesuar***, shoqëria përmbarimore "Strati Bailiff's Service" sh.p.k., nuk ka paraqitur

parashtrime lidhur me çështjen objekt shqyrtimi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës

18. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

19. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces.

20. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit dhe autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme *(shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Çështja konkrete është vlerësuar në vijim nga Gjykata Kushtetuese, në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme.

i) Kompleksiteti i çështjes

22. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së kërkuesit dhe i autoriteteve publike është me rëndësi në këtë kontekst.

ii) Sjellja e kërkuesit

23. Për sa i përket sjelljes, veprimeve të kërkuesit, nga tërësia e fakteve dhe rrethanave rezulton se kërkuesi, pas mbarimit të procesit gjyqësor për anulimin e vendimit për masën disiplinore të uljes në detyrë dhe transferimit, në datën 27.7.2012, i është drejtuar shoqërisë përmbarimore "Strati Bailiff's Service" sh.p.k. me kërkesë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5945, datë 16.7.2010, plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

24. Sa më sipër, kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar.

iii) Sjellja e autoriteteve

25. Në këtë drejtim, është e nevojshme fillimisht të vlerësohet nëse shoqëria përmbarimore "Strati Bailiff's Service" sh.p.k. ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e urdhrit të ekzekutimit në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Sipas kërkesës dhe dokumenteve të bashkëlidhura, rezulton se shoqëria

përmbarimore “Strati Bailiff’s Service” sh.p.k. është mjaftuar me lajmërimin për ekzekutim vullnetar nr. 5271 prot., datë 27.7.2012; ka dërguar në vazhdimësi shkresat me nr. 5431 prot., datë 2.8.2012 dhe nr. 2050 prot., datë 22.2.2013, por nuk ka ndërmarrë hapat e mëtejshëm proceduralë të nevojshëm për ekzekutimin e këtij vendimi.

26. Në lidhje me sjelljen e autoritetit tjetër, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, pasi vendimi ka marrë formë të prerë, ky autoritet nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta ekzekutuar. Kjo drejtori, me shkresën nr. 12262/3 prot., datë 16.8.2012, drejtuar Gjykatës së Lartë, ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 5945, datë 16.7.2010, i plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010, lënë në fuqi me vendimin nr. 1624, datë 8.7.2011 të Gjykatës së Apelit, i plotësuar me vendimin nr. 466, datë 25.10.2011. Në këtë shkresë ka parashtruar se ekzekutimi i këtij detyrimi do t’i sillte buxhetit të shtetit një dëm efektiv dhe të pariparueshëm.

27. Lidhur me pretendimin e subjektit të interesuar se kërkesa, objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, ka mangësi në objekt pasi ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, objekt i kërkesës, lidhet me transferimin nga detyra të kërkuesit, në një kohë kur kërkuesi ishte larguar nga detyra, Gjykata Kushtetuese çmon se ky pretendim është i pabazuar.

28. Nga materialet e ndodhura në dosje rezulton se vendimi i Drejtorisë së Doganave, për largimin nga detyra, ka dalë në një kohë kur kërkuesi ishte në proces gjyqësor për vendimin e transferimit dhe uljes në detyrë. Rezulton se para daljes së vendimit të largimit, me shkresën nr. 5844 prot., datë 4.5.2010, kërkuesi ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga detyra si doganier në degën e Doganës Vlorë. Bazuar në vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, subjekti i interesuar nuk mund të nxirrte aktin e dytë të largimit nga detyra, në një kohë kur kërkuesi nuk ishte në marrëdhënie pune, çka e bën aktin e largimit nga puna të pavlefshëm. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka pasur për detyrë të zbatojë pasojat juridike të vendimit gjyqësor me objekt anulimin e vendimit të transferimit nga pozicioni i punës së kërkuesit. Në kushtet kur pasojat juridike nuk ishin rregulluar, nuk mund të nxirrte një akt të dytë për largimin nga detyra.

29. Gjithashtu, i pabazuar është dhe pretendimi se vendimi nuk mund të ekzekutohet pasi vendi i punës nuk ekziston më në organikën e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

30. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 10, datë 1.3.2012 dhe nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Lidhur me afatet kohore, në çështjen konkrete rezulton se urdhri i ekzekutimit, i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mban datën 8.3.2012. Gjykata çmon se megjithëse *prima facie* nuk rezulton të jetë një afat i tejzgjatur kohor, nisur nga tërësia e rrethanave të çështjes, debitori (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave), ka pasur kohën e mjaftueshme në dispozicion për të ekzekutuar detyrimin ndaj kreditorit/kërkuesit. Debitori jo vetëm që nuk e ka bërë këtë, por vazhdon të shprehet se nuk do të kryejë veprimet e duhura në plotësim të detyrimeve të tij ndaj kreditorit. Gjykata vëren, gjithashtu, se edhe organi përgjegjës i ngarkuar me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, shoqëria përmbarimore “Strati Bailiff’s Service” sh.p.k., nuk i ka marrë të gjitha masat përkatëse në drejtim të zbatimit efektiv të vendimit gjyqësor. Nuk rezulton që sjelljet e kërkuesit të jenë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë, përkundrazi ai ka qenë aktiv në kërkimin e tij për rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar.

32. Në përfundim, Gjykata konstaton se në çështjen objekt shqyrtimi ndodhemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, dhe brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5945, datë 16.7.2010, i plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Vendosur, Tiranë, më 16.7.2013

Shpallur, Tiranë, më 17.10.2013